



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:115508

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05412675

CN.nr.153/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen juridike të paditësit F.K., nga fshati V....., Komuna e Pejës, Rr. "V..... G.....", ONIX, Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K., avokat nga Peja, kundër të paditurit B.C., nga Peja, Rr. "F..... e P.....", me bazë juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë dhe lirim i paluajtshmërisë, duke vendosur lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës, i paraqitur nga i autorizuari i paditësit, kundër aktvendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.424/2018 të datës 14.07.2022, me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

LEJOHET përsëritja e procedurës sipas propozimit të ushtruar nga i autorizuari i paditësit F.K., nga fshati V....., Komuna e Pejës dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.424/2018 i datës 14.07.2022, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të përsëritjes.

A r s y e t i m

Paditësi F.K., nga fshati V....., Komuna e Pejës, nëpërmes të autorizuarit avokatit A.K., nga Peja, ka parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës e cila ka përfunduar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.424/18 i datës 14.07.2022, i plotfuqishëm nga data 19.08.2022, propozimin e ka bazuar në nenin 232, pika a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Në propozim ka theksuar se gjykata e shkallës së parë, pasi që ish i autorizuari i paditësit A.K., ka kaluar në Universitetin Haxhi Zeka, ka dërguar postën në fshatin V....., Komuna e Pejës, ku nuk jeton paditësi dhe familja e tij ndërsa pastaj njoftimin e ka bërë në tabelën zyrtare të gjykatës dhe se paditësi nuk ka qenë i njoftuar, duke caktuar kështu seancën pa ftuar në mënyrë të rregullt

paditësin, duke theksuar në kërkesë të aprovet propozimi për përsëritje të procedurës dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.424/18 i datës 14.07.2022 për gjykim dhe rivendosje.

Propozimi për përsëritje të procedurës i është dërguar palës së paditur mirëpo i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në propozim.

Gjykatësja individuale e Gjykatës së Apelit të Kosovës, bëri shqyrtimin e shkresave të lëndës në pajtim me dispozitat e nenit 239 par.1 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve dhe shkaqeve të paraqitura në propozim, gjeti se:

-Propozimi është i lejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi nëpërmjet të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi kundër të paditurit për vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe lirimin e pronës. Gjykata e shkallës së parë ka tentuar që të ftoj palën paditëse për seancën e datës 13.06.2022, mirëpo nga fletë kthesa është konstatuar se: “marrësi është shpërngulur nga fshati, adresa Pejë, Univers restaurant, vendbanimi në Amerikë”. Duke pasur parasysh këtë konstatim, gjykata me aktvendimin C.nr.424/18 të datës 13.06.2022, ka vendosur që komunikimi shkresor me paditësin të bëhet përmes afishimit-publikimit të shkresave në tabelën e shpalljes të gjykatës dhe se kjo mënyrë e komunikimit do të bëhet derisa pala apo përfaqësuesi i tij do ta njoftoj gjykatën për adresën e re të vendbanimi-vendqëndrimit, duke njoftuar se seanca e radhës caktohet me datën 14.07.2022, në ora 14:00 dhe se paditësi do të ftohet me ftesë të veçantë.

Gjykata ka mbajtur seancën me datën 14.07.2022, në të cilën i padituri në mungesë të palës paditëse i ka propozuar gjykatës që ta konsideroj të tërhequr paditën e paditësit, meqë i njëjti nuk ka interes juridik që të vazhdoj shqyrtimin e kësaj çështje. Lidhur me këtë propozim gjykata vendosi me aktvendimin C.nr.424/18 të datës 14.07.2022, duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi pretendimet e paditësit të paraqitura në propozimin për përsëritje dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 232 paragrafi 1, pika a) të LPK-së, për lejimin e përsëritjes së procedurës të përfunduar me aktvendim të formës së prere, ngase gjykata e shkallës së parë, ka dështuar që me sukses ti shtjerë të gjitha mjetet për të siguruar pjesëmarrjen e paditësit në shqyrtimin kryesor të çështjes.

Me shikim në shkresa të lëndës, vërehet se gjykata nuk ka vepruar sipas autorizimit të palës paditëse, që të njëjtin për pjesëmarrje në seancë ta ftoj nëpërmjet të autorizuarit të tij avokat A.K., nga Peja, i cili ka autorizim në shkresat e lëndës, përkundër faktit se gjykata në aktvendimin e saj të datës 13.06.2022, ka arsyetuar se: “meqë për gjykatën është fakt i njohur se i autorizuari i paditësit avokat A.K., e ka ndërprerë ushtrimin e detyrës së avokatit pasi që i njëjti është emëruar rektor i Universitetit “Haxhi Zeka”, në Pejë, gjykata ka tentuar që paditësit ftesën t’ia dorëzoi personalisht”. Në këtë rast gjykata nuk ka zbatuar dispozitën e nenit 94 të LPK-së, pasi që pala paditëse nuk e ka revokuar autorizimin e dhënë e pa ashtu as përfaqësuesi i tij nuk

e ka bërë denoncimin, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka revokim apo denoncim të autorizimit i cili i është komunikuar gjykatës, andaj gjykata ftesën është dashur t'ia dërgoj përfaqësuesit të autorizuar, sipas autorizimit i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Në kreun e XIV të Ligjit Nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore, propozimi për përsëritjen e procedurës është përcaktuar si mjet i dytë i jashtëzakonshëm, me të cilin lejohet përsëritja nën kushtet e përcaktuara në nenin 232 të LPK-së, nën pikën a) *“në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore”*, andaj gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, nga shkresat e lëndës konstatoi se paditësit F.K., i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë lidhur me procesin që ishte duke u zhvilluar sipas padisë së tij, pasi që nuk është ftuar në mënyrë të rregullt, edhe pse i njëjti ka pasur përfaqësues të autorizuar, mbi këtë bazë propozimi për përsëritjen e procedurës i ushtruar nga paditësi ka bazë ligjore, andaj duke vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 240 par.2 të LPK-së, vendosi që ta anuloj aktvendimin C.nr.424/18 të datës 14.07.2022, i cili është bërë i formës së prerë dhe që çështja t'i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, në përsëritje të procedurës, me ç'rast është e obliguar që të caktoj seancë përgatitore, t'i thërret palët ndërgjyqës në mënyrë të rregullt, të administroj provat që gjenden në shkresa të lëndës dhe pas kësaj të nxjerr vendim të rregullt dhe të drejtë duke iu përmbajtur kushteve ligjore për formën dhe përmbajtjen e tij.

Gjykata e Apelit shqyrtoi edhe afatshmërinë e propozimit për përsëritje të procedurës, të paraparë me nenin 234 par.3 të LPK-së, mirëpo konsideroi se në rastin konkret vlen paragrafi 3, me të cilin parashihet se: *''Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveç kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232 par.1 pika a) dhe b) të këtij ligji''*.

Gjykata e Apelit konform nenit 239 paragrafi 1, lidhur me nenin 240 paragrafi 2, të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke lejuar përsëritjen e procedurës.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË,
CN.nr.153/2023, me datë 05.03.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti

Këshilla juridike:
Kundër këtij aktvendimi, nuk është e
lejuar ankesa neni 240, paragrafi 3 i LPK-së.